



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3206/5 prot.

Datë 10.12.2025

V E N D I M

Nr. 1825/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 10.12.2025 me

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “START CO” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-61577-09-16-2025, me objekt: “Blerje mjete eskavator me goma”, me fond limit 10,000,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 09-10-2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kukes.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Kukes, me adresë: ”Sheshi Skënderbej”, Lagja nr.5, Kukës.

Ankimues: “ARTEO 2018” SHPK, me NIPT (L82523203F), me adresë: Bulevardi Aqif Pasha, Hotel Skampa.

Subjekte të Interesuara: “START CO” SHPK, me NIPT (L11614001S), me adresë: Bulevardi Gjergj Fishta, Kulla G&P, Kati 1, Tiranë

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:**I***Vlerësimi Paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 17-09-2025 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-61577-09-16-2025, me objekt: “Blerje mjeti eskavator me goma”, me fond limit 10,000,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 09-10-2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kukes..

II.2. Në datën 09-10-2025, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor më datë 03.11.2025, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “START CO” SHPK	9,522,000 lekë Kualifikuar
2. “ARTEO 2018” SHPK	9,885,000 lekë Kualifikuar
3. “NAOL” SHPK	0 lekë Skualifikuar

II.4 Në datën 04.11.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftim-Fituesi paraprak në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.5. Pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2025/6061, datë 10.11.2025 dhe me nr. protokoli 3206/2025 datë 10.11.2025 e operatorit ekonomik “ARTEO 2018” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-61577- 2 09-16-2025, me objekt: “Blerje mjeti eskavator me goma”, me fond limit 10,000,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 09-10-2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kukes.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.3206/1 prot, datë 11.11.2025, lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitura nga operatori ekonomik “START CO” SHPK, në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit.

II.7. Autoriteti kontraktor ka përcjellë me shkresën nr. 6247 prot., datë 27.11.2025, protokolluar me tonën me nr.3206/2 prot., datë 02.12.2025, vendimin e KSHA mbi trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimes “START CO” SHPK. Referuar shkresës së sipërcituar të Autoritetit kontraktor, rezulton, se ky i fundit ka vendosur të mos pranojë ankesën e sipërcituar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Përpara shqyrtimit në themel të ankesës të paraqitur nga operatorëve ekonomik “ARTEO 2018” SHPK, Komisioni vlerëson të ndalet dhe të shqyrtojë respektimin e kushteve formale të ankesës ekonomik ankimes, ku një prej të cilave është edhe paraqitja e ankesës sipas formularit përkatës, në mbështetje të nenit 111 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

III.1.1 Nga verifikimi i dokumentacionit të ndodhur në fashikullin administrativ rezulton se në datë 10.11.2025 operatori ekonomik “ARTEO 2018” SHPK ka dorëzuar nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike ankesën me nr. ankimi elektronik A/2025/6061, datë 10.11.2025 dhe me nr. protokolli 3206/2025 datë 10.11.2025.

Nga verifikimi i ankesës së dorëzuar në Sistemin e Ankesave Elektronike, Komisioni konstaton, se ajo nuk është bërë sipas formularit përkatës të dokumentave standarte të tenderit të miratuara me vendim nga Agjencia e Prokurimit Publik.

Në mbështetje të pikës 3 të nenit 111 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar ku përcaktohet se: *“Nëse mungon ndonjë nga elementet e sipërpërmendura ose formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë autoriteti ose enti kontraktor duhet të vërë në dijeni ankimesin për të plotësuar formularin. Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë edhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet. Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 2 ditëve nga njoftimi, ajo vlerësohet si e paparaqitur”*, Komisioni i Prokurimit Publik, nga shqyrtimi i dokumentacionit të ndodhur në fashikullin administrativ gjykon se, operatori ekonomik ka paraqitur ankesën nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike ashtu sic përcaktohet në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, por ky i fundit nuk ka paraqitur formularin e ankesës sipas shtojcës “Formulari i Ankesës pranë Autoritetit/Entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik”, të dokumentave standarde të tenderit të miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik.

Referuar pikës 2 të nenit 111 të LPP-së parashikohet shprehimisht se: *“2. Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës së ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat mendon se mbështesin ankimin e tij.*

Elementet e sipërpërmendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Ankimuesi është i detyruar t'i bashkëlidhë ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën. Nga ana tjetër në pikën 3 të po këtij neni parashikohet shprehimisht se: “3. Nëse mungon ndonjë nga elementet e sipërpërmendura ose formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë autoriteti ose enti kontraktor duhet të vërë në dijeni ankimuesin për të plotësuar formularin. Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë edhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet. Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 2 ditëve nga njoftimi, ajo vlerësohet si e paparaqitur”.

Referuar bazës ligjore të sipërcituar është autoriteti kontraktor i cili duhet të kryejë veprime procedurale për njoftimin e operatorit ekonomik ankimues për ndreqjen e të metave të ankesës.

Referuar shkresës së autoritetit kontraktor me nr. 6247 prot., datë 27.11.2025, protokolluar me tonën me nr.3206/2 prot., datë 02.12.2025, rezulton që autoriteti kontraktor nuk ka kryer veprime procedurale për njoftimin e operatorit ekonomik ankimues për ndreqjen e të metave të ankesës. Në kushtet kur autoriteti kontraktor nuk ka kërkuar ndreqjen e të metave të ankesës në zbatim të pikës 3 të nenit 111 të LPP-së, si dhe referuar ankesës së paraqitur në SAE nga OE ankimues Komisioni konstaton, se në ankesën e dorëzuar evidentohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, pagesa e tarifës së ankesës, rrethanat e çështjes, shkaqet e ankimit, ankesës. Si rrjedhojë në kushtet kur autoriteti kontraktor nuk ka kërkuar ndreqjen e të metave të ankesës përsa i përket formularit të ankesës, në kushtet kur ankesa është dorëzuar nëpërmjet SAE dhe evidentohen të gjitha të dhënat e përcaktuara në nenin 111 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Komisioni gjykon se ankesa e dorëzuar pranë KPP-së plotëson kushtin formal lidhur me formularin e paraqitjes së ankesës.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “ARTEO 2018” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së paraqitur prej operatorit ekonomik “Start CO” SHPK me arsyen se : “...kemi bindjen që kualifikimi i operatorit ekonomik START CO është bere ne kundërshtim me ligjin, pasi objekti Eskavator me goma i ofruar nga ky operator ekonomik nuk i permbush specifikimet teknike si fuqia P 110 KF dhe parametrat e tjere te kerkuar ne specififikimet teknike. Po keshtu edhe aksesoret e tjere nuk permbushin specifikimet teknike si Prerese metalike dhe Matrapik per eskavatore. Prandaj kerkojme nga Autoritetit tuaj Kontraktor te behet revleresimi korrekt nga ana juaj.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në dokumentet e tenderit, shtojca 6 “*Formulari I Specifikimeve Teknike*”, e procedurës së prokurimit objekt - ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:”

“FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Të përqijhtshme

- Viti Prodhimit: 2022-2025
- Gjendja e mjetit: I Ri

- *Pesha:* *Jo me i vogel se 9500 kg*
- *Motori:* *~ 4.5 L*
- *Fuqia e motorrit:* *~ 110 KF*
- *Emisioni:* *Min Stage III A*
- *Lënda djegëse:* *Naftë*
- *Transmision:* *Manual ose poërsshift (4 para / 4 mbrapa)*
- *Lëvizje:* *4x4*
- *Presioni hidraulik:* *~220 bar*
- *Rrjedha pompës:* *~90 L/min*
- *Kapacitet depozite vaji:* *~ 75 L*
- *Kapacitet karburanti:* *~150 L*
- *Lartësia kabinës:* *~ 3,000 mm*
- *Gjatësia totale:* *~ 6,100 mm*
- *Distanca aksiale:* *~ 3000 mm*
- *Kova e ngarkimit:* *~ 1.1 m³*
- *Gjerësia e kovës:* *~ 2,440 mm*
- *Kapacitet ngritës:* *3000 ~3,200 kg*
- *Kovat e gërmimit:* *0.2-1.2 m³ (komplet seti i kovave)*
- *Thellësia gërmimi:* *~5,700 mm*
- *Hapja e krahut në nivel toke:* *~ 6,900 mm*
- *Kabinë me ROPS/FOPS,*
- *Joystick për kontrollin e mjetit*
- *Sistem ajri kondicionuar*
- *Ekran në panelin para dhe në pjesën e pasme*
- *Ngritje automatike e timonit*
- *Gomat: 4 të njëjta*
- *Linjë hidraulike për paisje shtesë: Po*
- *Sistem i dyfishtë frenimi*

III.2.2. Ndërsa në dokumentet e tenderit, shtojca 8 “*Formular i Kritereve Të Përzgjedhjes/Kualifikimit*”, e procedurës së prokurimit objekt - ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:”

“2.3 Kapaciteti teknik:

4. *Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog (ne gjuhen shqipe) ose skedë teknike nga prodhuesi /ose distributori i autorizuar ku të tregohen dhe të markohen qartë karakteristikat teknike të mjeteve të ofruara, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria e tyre me specifikimet*

teknike dhe standartet e kërkuara në dokumentat standarte të tenderit, të përcaktuara në Shtojcën 6 të DST-së.”

III.2.3. Sa më sipër, referuar kërkesave të vendosura nga autoriteti kontraktor për sa i përket kritereve të vecanta pikës 2.3 dhe specifikimeve teknike, operatori ekonomik “STAR CO” SHPK, ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), dokumentacionin si më poshtë:



Katalog_Cekic_Hidraulik (1).pdf



Katalog_fadrom_102B_Alpha (2).pdf



Autorizim_prodhuesi (1).pdf



Katalog_prerese_metalike (1).pdf



COC_e_mjetit_fadrom_102B_Alpha (2).pdf

III.2.4. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: *“Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

III.2.5. Neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”*

III.2.6. Në nenin 77, pika 1 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” , i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. [...] 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

III.2.7. Në Nenin 92 pika 3 te ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.”

III.2.8. Në nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 3, e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “ 1. Në procedurat e prokurimit për mallra, autoriteti/enti kontraktor parashikon sasinë e mallrave që do të lëvrojë, si dhe grafikun e lëvrimit të mallrave. 2. Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara. 3. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i

kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”

III.2.9. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që shërbimi/malli/puna e ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e kriterëve kualifikuesë dhe specifikimeve teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues, në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret kualifikuesë dhe specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i shërbimeve/mallrave/punëve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret dhe specifikimet teknike të shërbimit të përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt prokurim.

III.2.10. Në këtë rast, referuar dhe sa më sipër, Komisioni konstaton, se në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar në pikën 2.3.4 kapaciteti teknik, dokumentet që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Star CO” SHPK në përmbushje të kriterit të veçantë të kualifikimit, pika 2.3.4 kapaciteti teknik dhe të specifikimeve teknike KPP konstaton,

se ky i fundit, ka dorëzuar dokumentacionin me titullin “*Katalog_fadrom_*”(në përmbajtje të të cilit konstatohen specifikimet e kërkuara të noterizuara dhe përkthyer në gjuhën shqipe për eskavatorin me goma), “*Katalog_Cekic_Hidraulik*” (në përmbajtje të të cilit konstatohet katalogu i noterizuar dhe përkthyer në shqip për matrapikun e eskavatorit) dhe “*Katalog_prerese_metalike*” (në përmbajtje të të cilit konstatohet katalogu i noterizuar dhe përkthyer në gjuhën shqipe për prerësen metalike të eskavatorit). Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues, si pjesë të ofertës së tij, ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar në dokumentet standarde të tenderit për kriterin e mësipërm për specifikimet teknike pasi prej përmbajtjeve të dokumentave të dorëzuara në SPE nga operatori ekonomik “Star CO” SHPK konstatohet letësisht plotësimi i kriterit 2.3.4 dhe i specifikimeve sikurse kërkuar nga autortiteti kontraktor. Konkretisht është kërkuar që mjeti eskavator me goma të ketë ndër të tjera fuqin e motorrit: ~ 110 KF dhe OE në katalogun e paraqitur ka ofertuar një eskavator me fuqin e motorrit 100 KF që rrjedhimisht nga kërkesa e autoriteti kontraktor që kërkon një fuqi të përafërt me 110 KF rezulton e përmbushur nga operatori ekonomik ”START CO” SHPK. Komisioni gjykon se me të drejtë autortiteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit dhe janë operatorët ekonomik pjesëmarrës që me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që shërbimi/malli/puna e ofruar është në përputhje me parametrat teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Nga sa parashtuar dhe më sipër KPP gjykon se operatori ekonomik “Star CO” SHPK ka plotësuar kriterin teknik 2.3.4 dhe specifikimet teknike të dokumentave të tenderit.

-Nga ana tjetër operatori ekonomik ankimues “ARTEO 2018” SHPK më anë të ankesës A/2025/6061, datë 10.11.2025 dhe me nr. protokoli 3206/2025 datë 10.11.2025 në arsyetimin e tij nuk ka identifikuar apo argumentuar specifikime të tjera konkrete lidhur edhe me aksesoret e kërkuar të makinerisë duke u mjaftur me një arsyetim se “*Po kështu edhe aksesoret e tjere nuk përmbushin specifikimet teknike si Prerese metalike dhe Matrapik per eskavatore.*”, ndaj Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, një pretendim në total, pa argumente të arsyeshme apo indicie të qarta, mbi të gjithë apo shumicën e elementeve përbërëse të ofertës së konkurrentit/konkurrentëve të kualifikuar para tij ose të barabartë me të në ofertë ekonomike, do të konsiderohet abuziv, në kundërshtim me qëllimin e veprimtarisë së Komisionit, pasi cenon efikasitetin dhe shpejtësinë e procedurës së prokurimit publik dhe nuk do të merret në shqyrtim nga KPP.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “ARTEO 2018” SHPK, në procedurën e prokurimit, “E hapur”, me Nr. REF-61577-09-16-2025, me objekt: “Blerje mjeti eskavator me goma”, me fond limit 10,000,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 09-10-2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kukes.
2. Autoriteti kontraktor të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kalimin në buxhetin e shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “ARTEO 2018” Shpk.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

